



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1254 Prot.

Tiranë, më 18/08 2025

VENDIM

Nr. 39, datë 18/08 /2025

PËR

**MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOSJES SË KANDIDATIT DR. ROVENA KUKA
PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK "PROFESOR I ASOCIUAR" PRANË
KOMISIONIT PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, në nenin 60, pika 3, në nenin 79, pika 7 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 10.03.2021 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë", në Kreun IV, pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, në nenin 24 dhe 67 të Statutit të Universitetit të Arteve, si dhe në nenin 17, pika 1 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, të Universitetit të Arteve", pasi shqyrtoi dosjen dhe diskutoi mbi të,

VENDOSI:

1. Të miratojë përcjelljen e dosjes së **Dr. Rovena Kuka** për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", pranë Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të UART.
2. Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Ky vendim të përcillet pranë Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik dhe Fakultetit të Muzikës dhe të publikohet në faqen zyrtare të UART.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Prof. Najada Hamza



Prof. Arben Llozi



Prof. Miltiadh Kutali



Prof. Sadik Spahija



Prof. Lorenc Radovani



Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)

Prof. Endri Sina



Prof. Rudina Ciko



Prof. Gazmend Gjoka



Prof. Asoc. Dorian Çene

Prof. Asoc. Albes Fusha



Prof. Asoc. Edmond Gjikapulli



Prof. Asoc. Kristina Laço



Prof. Asoc. Genci Fuga



Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Prof. Asoc. Orion Shima



Enea Trimi (Student FAB)

Rei Kita (Student FM)